



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË SKRAPAR

VENDIM

Nr 53, datë 28.10.2025

**PËR DHËNIEN E TITULLIT “QYTETAR NDERI I SKRAPARIT” PROFESOR
DOKTOR BAHRI MUSABELLIU**

Këshilli Bashkiak Skrapar në mbledhjen e datës 28.10.2025, mori në shqyrtim projektaktin e hartuar nga Grupi i Menaxhimit Strategjik, mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, ligjit nr.94/2022 “Për Titujt e Nderit dhe Titujt Vendor të Nderit në Republikën e Shqipërisë”

VENDOSI:

Dhënien e titullit “Qytetar Nderi i Skraparit” Profesor Doktor Bahri Musabelliu me motivacion:

Në vlerësim të lartë të veprimtarisë së tij të shquar profesionale akademike dhe shkencore në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural. Personalitetet që me një karrierë dhjetra vjeçare ka dhënë kontribute të çmuara në fushën e arsimit, si pedagog dhe drejtues i Universitetit Bujqësor të Tiranës, duke kontribuar në përgatitjen e brezave të tërë të profesionistëve të ekonomisë dhe bujqësisë në Shqipëri. Model i qytetarit dinjitoz, me integritet të lartë, i respektuar nga kolegët dhe studentët, i cili me punën tij të palodhur i ka bërë një shërbim të vyer shoqërisë dhe vendit.

Vendimi u miratua me 12 Vota pro, vota kundër - s'ka , abstenim – s'ka

Për konfirmim Prefektit të Qarkut Berat.

KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

Elsa PETRITAJ

